



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 11, datë 30.04.2025

PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË SIPËRFAQES PYJORE NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.37, DATË 01.08.2023 TË KKT-SË “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN RESORT TURISTIK LURA 5, FAZA 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA Durrës”

Në zbatim të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 26.01.2017 “Per mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar”, VKM-së nr. 591/2018, VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Per përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, të ndryshuar, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor” i ndryshuar, shkresës së Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit nr. 1667/1 prot, datë 12.03.2025, si edhe sipas relacionit të hartuar nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drektorisë Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Dhënie e dakordësisë për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore nga fondi pyjor kombëtar, në zbatim të Vendimit nr.37, datë 01.08.2023 të KKT-së “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik Lura 5, faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Ligjore, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi




U shpall sot me datë 02.05.2025






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 315/4 prot.



Durrës, më 12 . 05 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.11 datë 30.04.2025 ,” Për dhënien e dakortësisë për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore nga fondi pyjor kombëtar , në zbatim të vendimit nr.37 datë 01.08.2023 të KKT-së, ”Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik Lura 5, Faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

